



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit




01- Nr 112 - 3750 dt. 21/01 2020

Në vështrim të nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, në bazë të nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Marrëveshjes Nr.01-400/01-3380, të datës 20.01.2020, e lidhur në mes Komunës së Drenasit dhe Organizatës Help, nenit 49 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës në Drenas, mori këtë:

V E N D I M

Për caktimin e personit përgjegjës për monitorimin e projektit “ Mbështetje stabilitetit socio-ekonomik në Kosovë”

- I. Znj. Violeta Baleci caktohet person përgjegjës për monitorimin e projektit me titull:
“ Mbështetje stabilitetit socio-ekonomik në Kosovë”
- II. Personi përgjegjës për monitorim të projektit të lartcekur sipas marrëveshjes së lidhur në mes të Komunës së Drenasit dhe Organizatës Help të datës: 20.01.2019, me Nr: 01-400-3380, ka për obligim që të monitoroj aktivitetet në kuadër të zbatimit të Projektit HELP në të gjitha fazat.
- III. Monitoruesja e projektit për punën dhe rrjedhjen e procesit të këtij projekti i përgjigjet: Kryetarit të Komunës dhe Drejtoreshës së Zhvillimit Ekonomik, të cilën punë duhet ta kryej me përkushtim të lartë dhe profesionalizëm.
- IV. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.


Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

Iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Personelit;
- Znj. Violeta Baleci;
- DZHE-së;
- Arkivit të Komunës së Drenasit.